

NDIHMJA EKONOMIKE

Ndihmë ekonomike përfitojnë:

1. Familjet pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme;
2. Jetimët të cilët nuk janë në institucione;
3. Prindërit e fëmijëve të lindur trinjakë e më shumë njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë;
4. Viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore deri në çastin e punësimit të tyre;
5. Viktimat e dhunës në marrëdhënie familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrin të mbrojtjes ose të urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes.
6. Fëmijë të vendosur në shërbimin e kujdestarisë

Aplikimi dhe Dokumentacioni

Familjet pa të ardhura dhe me të ardhura të pamjaftueshme dhe kategoritë e tjera mund të aplikojnë për përfitimin e ndihmës ekonomike me document identifikimi (ID) pranë njësisë administrative ku kanë vendbanimin.

Për të përfituar ndihmë ekonomike kryefamiljari, së bashku me bashkëshorten nga data 1-10 të çdo muaji paraqiten pranë administratorit shoqëror të njësisë administrative, ku bëhet aplikimi online për ndihmë ekonomike si familje në nevojë.

Vendimi për përfitimin e ndihmës ekonomike dërgohet zyrtarisht pranë njësisë administrative ku ka vendbanimin personi.

Viktimat e Trafikimit

Pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore, deri në çastin e punësimit të tyre në muajin e parë të pretendimit për ndihmë ekonomike, duhet të paraqesin pranë administratorit shoqëror:

1. Fotokopjen e kartës së identitetit;
2. Vërtetimin e trajtimit në institucionet e përkujdesjes shoqërore, të lëshuar brenda 30 ditëve të fundit.

Viktimat e dhunës në marrëdhënie familjare

Viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare që nuk trajtohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrin të mbrojtjes ose të urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes në muajin e parë të pretendimit për ndihmë ekonomike, duhet të paraqesin pranë administratorit shoqëror:

1. Urdhër mbrojtje ose urdhër i menjëhershëm mbrojtje;
2. Fotokopje e kartës së identitetit të aplikuesit.

Individët që kanë marrë Statusin e Jetimit, që nuk jetojnë në institucionet e përkujdesit

Në muajt e parë të pretendimit për ndihmë ekonomike duhet të paraqesin pranë administratorit shoqëror:

1. Fotokopje e kartës së identitetit të aplikuesit.
2. Kopje e noterizuar e Statusit të Jetimit;

3. Vërtetim si punëkërkuar i papunë, lëshuar nga Zyra e Punës, për jetimët mbi moshën 18 vjeç.

Prindërit me më shumë se dy fëmijë të lindur njëherësh

Në muajin e parë të pretendimit për ndihmë ekonomike duhet të paraqesin pranë administratorit shoqëror:

1. Kërkesë për t'u trajtuar me ndihmë ekonomike si familje me tre, katër, pesënjakë;
2. Certifikatë familjare që vërteton lindjen e fëmijëve tre, katër, pesënjakë;
3. Verifikimi social-ekonomik i familjes nga administratori shoqëror, që është familje në nevojë.

Nëpërmjet portalit e-albania, qytetarët që kanë aplikuar për ndihmë ekonomike, mund të kontrollojnë online statusin e aplikimit të tyre, si dhe të shohin informacion mbi ndihmën që ata kanë marrë gjatë 12 muajve të fundit, link:

https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=4435

Përfitime / subvencione

1. Kompensimi i Energjisë Elektrike në masën 1288 lekë sipas VKM-së Nr.8, datë 14.01.2015 dhe VKM-së Nr.565, datë 09.08.2006 ku parashikohen procedurat dhe dokumentacioni;
2. Vendosjen e matësve të ujit dhe lidhjen e kontratës së ujit pa pagesë sipas VKM-së Nr.18, datë 12.01.2018 ku parashikohen procedurat dhe dokumentacioni;
3. Kompensimi për konsumin e sasisë minimale jetike të ujit të pijshëm, tarifës fikse, tarifës së kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotur urban sipas Udhëzimit 2, datë 26.3.2024 ku parashikohen procedurat dhe dokumentacioni;
4. Përfitim i statusit të klientit në nevojë për furnizimin me gaz natyror sipas VKM-s Nr.8, datë 11.01.2024 ku parashikohen procedurat dhe dokumentacioni;
5. Përfshirje nga tarifa e studimit në Universitet dhe Bursë shkollimi në masën 10.000 lekë për çdo fëmijë;
6. Subvencion për arsimin e detyrueshëm në masën 300 lekë për çdo fëmijë/ tekstet shkollore falas për arsimin e detyrueshëm;
7. Çerdhe dhe kopësht falas për fëmijët e familjeve në nevojë;
8. Vizitë mjekësore falas/rimbursim i ilaçeve për familjet në nevojë;
9. Subvencion për çdo vaksinë të kryer në masën 100 lekë;
10. Subvencion strehimi/ bonus qeraje për familjet në nevojë;
- Punësim dhe formim profesional për familjet në nevojë të cilët kanë anëtarë në moshë aktive pune, në bashkëpunim me AKPA-në;
11. Gratë e papuna me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç, përfitues nga skema e NE-së, periudha e kujdesit ndaj fëmijës deri në moshën 5-vjeçare njihet si periudhë sigurimi për efekt përfitimi pensioni pleqërie dhe barrë lindjeje sipas VKM-së Nr. 751, datë 1.12.2022 ku parashikohen procedurat dhe dokumentacioni;
12. Përfshirje nga tarifat për regjistrimin e pasurive të paluajtshme për familjet në nevojë.

Ankimimi

1. Aplikuesit për përfitimin e ndihmës ekonomike, kur gjykon se vendimi zyrtar i organit përkatës është i padrejtë mund të paraqesin ankesë me shkrim pranë bashkisë/njësisë administrative brenda 20 ditëve kalendarike nga marrja e njoftimit. Struktura vendore shqyrton ankesën dhe njofton me

shkrim ankuesin brenda 7 ditëve kalendarike nga marrja e ankesës.

2. Aplikuesi për përfitimin e ndihmës ekonomike ka të drejtë të paraqesë ankesë me shkrim pranë strukturës rajonale të Shërbimit Social Shtetëror brenda 20 ditëve kalendarike nga marrja e përgjigjes nga struktura vendore, pas ezaurimit të ankimit, të përcaktuar në pikën 1.

3. Struktura rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, pas shqyrtimit dhe verifikimit të ankesave, njofton me shkrim të interesuarin dhe njësinë e vetëqeverisjes vendore brenda 14 ditëve kalendarike nga marrja e ankesës.

4. Aplikuesi për përfitimin e ndihmës ekonomike, që pretendon se i është shkelur dhe/ose mohuar një e drejtë ligjore, gëzon të drejtën për të ngritur padi në gjykatë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

AFTËSIA E KUFIZUAR

Pagesë të aftësisë së kufizuar përfitojnë:

1. Personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të cilët deklarohen me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë se janë bërë të tillë, pavarësisht nga shkaku dhe moshë;
2. Personat me aftësi të kufizuar, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, si dhe personat e paaftë për punë, sipas Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, të cilët nuk plotësojnë kushtet ligjore për përfitim të pensionit të invaliditetit të punës sipas ligjit të sigurimeve shoqërore në Republikën e Shqipërisë;
3. Personat me aftësi të kufizuar, të deklaruar të tillë me vendim të Komisionit Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar;
4. Personat me mungesë të plotë ose të pjesshëm shikimi, të lindur ose të fituar, të cilët sipas kriterëve mjekësorë janë të paaftë për punë në kushte normale.
5. Personat, të cilët janë deklaruar invalidë pune me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, që përfitojnë pension invaliditeti dhe shtesë mujore mbi të, sipas Statusit të Invalidit të Punës.

Për secilën nga kategoritë e mësipërme, informacioni mbi procedurën e vlerësimit të aftësisë së kufizuar, dokumentacionin dhe kriteret merret pranë administratorit shoqëror të njësisë administrative, nën juridiksionin e së cilës ka vendbanimin personi,.

Pas procedurës së vlerësimit, personi pajiset me dokumentin që vërteton aftësinë e kufizuar, i cili dërgohet zyrtarisht pranë njësisë administrative ku ka vendbanimin personi.

Personat me aftësi të kufizuar pajisen me Vërtetim për Pagesën e Aftësisë së Kufizuar përmes platformës e-albaniatë, në link:

https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13839

Aplikimi për vlerësim të aftësisë së kufizuar

Qytetari i cili kërkon të vlerësohet për përfitime të aftësisë së kufizuar duhet të plotësojë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formulari i Mjekut të Familjes;
- Formulari i Mjekut Specialist/ QKSHM-ve në rastin e sëmundjeve të shëndetit mendor;
- Ekzaminimet përkatëse sipas sëmundjes;
- Dokument Identifikimi;

Dokumentacioni dorëzohet nga qytetari pranë komisionit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe vlerësimi realizohet brenda 30 ditëve.

Aplikimi për status para-tetraplegjiku / verbërie

Personat, që vlerësohen me aftësi të kufizuar, pajisen nga institucioni i kujdesit shëndetësor, i specializuar me shtretër, me fletën e drejtimit për në KMCAP. Për rivlerësim shqyrtohet dokumentacioni mjekësor i rekomanduar nga komisioni në vlerësimin e fundit. Dokumentacioni për vlerësimin/rivlerësimin e aftësisë së kufizuar, së bashku me kopje të dokumentit të identifikimit, dërgohen brenda 5 (pesë) ditëve nga institucioni shëndetësor pranë njësisë administrative kuindividit ka vendbanimin. Për të verbërit fleta e drejtimit për në KMPV lëshohet nga KML.

Përfitime / subvencione

1. Rimbursim i pagesës së energjisë elektrike apo telefonisë VKM-së Nr.8, datë 14.01.2015 dhe VKM-së Nr.565, datë 09.08.2006 dhe VKM nr. 404, datë 20.6.2012 ku parashikohen procedurat dhe dokumentacioni;
2. Përjashtim nga tarifa vjetore e studimit për studentët të cilët kanë një vendim si përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar dhe studentët që kanë të paktën njërin nga të dy prindërit me aftësi të kufizuara;
3. Personat me aftësi të kufizuara që ndjekin shkollën ose trajnimin profesional përfitojnë 200% të përfitimit bazë të aftësisë së kufizuar, ndërsa ata që ndjekin arsimin e lartë përfitojnë 300% të përfitimit bazë;
4. Shërbime sociale, ndërmjetësim punësimi, aftësim profesional falë Marrëveshjeve të Bashkëpunimit me AKPA-s, pushtetin vendor, zyrat arsimore, ANAD për gjuhën e shenjave etj.

Procedura e ankimimit për PAK

1. Aplikuesi ka të drejtën e ankimimit për procedurën e vlerësimit në rastet e refuzimit të aplikimit për përfitime për shkak të aftësisë së kufizuar. Ankimimi bëhet me shkrim, brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike, nga data e marrjes së njoftimit të vendimit nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, pranë komisionit të shqyrtimit të ankesave në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, e cila shqyrton dokumentacionin e ankimuesit, kryen intervistën sipas formularit 6, bashkëlidhur këtij vendimi dhe merr vendimin përfundimtar. Në rastet kur kërkesa pranohet, personit i lind e drejta e marrjes së përfitimeve që nga muaji pasardhës, nga data e marrjes së vendimit për refuzim nga komisioni.

2. Personi me aftësi të kufizuar, që pretendon se i është shkelur dhe/ose mohuar një e drejtë, gëzon të drejtën për të ngritur padi në gjykatë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, pasi ka ezauruar shkallët e ankimimit administrativ. Personit i lind e drejta e marrjes së përfitimeve, sipas afateve të përcaktuara në vendimin e gjykatës.

Procedura e ankimimit për Para-Tetraplegjikët dhe të Verbrit

1. Kundër vendimit të KMCAP-së së nivelit të parë personi mund të bëjë ankim brenda 30 (tridhjetë) ditëve në komisionin Epror. Ankimi në komisionin Epror bëhet me shkrim dhe dorëzohet pranë drejtorive rajonale të shërbimit social shtetëror. Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës, drejtoria rajonale e shërbimit social shtetëror dërgon në Shërbimin Social Shtetëror dosjen e ankimuesit, së bashku me një relacion të hollësishëm, ku argumentohet vendimi i marrë nga KMCAP-ja e nivelit të parë. Shërbimi Social Shtetëror njofton anëtarët e KMCAP-së Eprore dhe ankimuesit 7 (shtatë) ditë përpara zhvillimit të seancës së komisionit Epror. Vendimi i komisionit Epror arkivohet në dosjen përkatëse dhe i njoftohet me shkrim edhe ankimuesit, brenda një afati 8-ditor. Nëse ankimuesit nuk paraqiten para komisionit 2 herë radhazi dhe refuzojnë të kryejnë ekzaminimet e kërkuara apo mjekimin e rekomanduar, komisioni Epror merr vendim “pa aftësi të kufizuar”, dhe dosja i kthehet drejtorisë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror. Në këtë rast, dosja konsiderohet e mbyllur dhe për rihapjen e saj do të ndiqet procedura si për rastet që paraqiten para komisionit për herë të parë. Komisioni Epror nuk mund të marrë në rishqyrtim rastet për të cilat ai është shprehur një herë, në rastet kur ankimuesi ka të njëjtën gjendje shëndetësore, për të cilën pretendohet aftësi e kufizuar.

FONDI SOCIAL

Fondi Social është një mekanizëm mjaft i rëndësishëm që mbështet financiarisht ngritjen e shërbimeve sociale në komunitet për njësitë e qeverisjes vendore. Fondi Social ka si qëllim kontributin e drejtpërdrejtë në ofrimin e shportës së shërbimeve sociale për kategoritë në nevojë në nivel lokal përmes ngritjes së shërbimeve të reja ku nevoja e familjes dhe individit është me e madhe ose në përmirësimin e shërbimeve ekzistuese si pjesë e planeve sociale të bashkive.

Fondi Social është një mekanizëm që kombinon fondet publike, fondet e veta të bashkisë, dhurimet dhe burimet e tjera financiare, për të financuar shërbimet shoqërore në nivel lokal. Kështu, Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 111, datë 23 shkurt 2018, “Për krijimin dhe funksionimin e Fondit Social”, vendosi krijimin e fondit social si një mekanizëm financiar për NjQV-të, me qëllim përmirësimin e standardeve dhe kapaciteteve administruese të shërbimeve ekzistuese, planifikimin e krijimin e shërbimeve të reja dhe hartimin e politikave sociale.

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 150, datë 20/03/2019, “Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror”, përcakton mënyrën e planifikimit, përdorimit dhe shpërndarjes së fondit social qendror

Përshkrimi i Prgramit të financimit të Fondit Social:

- ✓ NjQV-ja vlerëson nevojën për shërbime dhe e pasqyron në Planin e Zhvillimit Strategjik dhe në Programin Buxhetor Afatmesëm.
- ✓ NjQV-ja vlerëson kapacitetet financiare dhe burimet njerëzore që mbështetin ofrimin e shërbimeve.
- ✓ Bashkitë hartojnë dhe miratojnë, me vendim të Këshillit Bashkiak, Planet Sociale tre vjeçare, ku parashikohen projektet e buxhetuaralidhur me shërbimet e kujdesit social.
- ✓ Ministria përgjegjëse për çështjet sociale parashikon në buxhetin e saj fonde për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat u transferohen NjQV-ve ku funksionojnë shërbimet, bazuar në buxhetimin e planeve sociale.

Në këtë kuadër, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, shpall thirrjen për aplikime për njësitë e qeverisjes vendore për 61 bashkitë kanë të drejtë të paraqesin kërkesat, e cila publikohet në faqen zyrtare të MSHMS-së, në linkun: <https://shendetesia.gov.al/njoftime-2/>.

Programi i mbrojtjes së veçantë nga shteti, për gratë e papuna, me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç

Shërbimi elektronik "Aplikim për përfitim nga programi i mbrojtjes së veçantë nga shteti për gratë e papuna me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç" ju mundëson të gjithë grave të papuna me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç, ku njëri prej fëmijëve është nën moshën 5 vjeç dhe familja ka të ardhura nën 100,000 (njëqind mijë) lekë në muaj, njohjen si periudhë sigurimi për efekt përfitimi pensioni pleqërie dhe barrë lindjeje, periudhën e kujdesit ndaj fëmijës deri në moshën 5-vjeçare.

Hyr në portalin E-Albania, identifikohu si Qytetar, vendos numrin personal të kartës së identitetit dhe zgjidh shërbimin "Aplikim për përfitim nga programi i mbrojtjes së veçantë nga shteti për gratë e papuna me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç". Pasi zgjedh këtë shërbim të shfaqet i gjithë informacioni përfitimin nga programi i mbrojtjes së veçantë nga shteti.

Për këtë shërbim nuk nevojitet asnjë dokumentacion shoqëruar dhe koha e marrjes së shërbimit është e menjëhershme.

Nëse kriteret e përfitimit nga ky program janë plotësuar, menjëherë mesazhi I konfirmimit të përfitimit nga ky program.

BONUSI I BEBES

Prindi/Prindërit e foshnjës së porsalindur do të paraqiten për tërheqjen e çekut të bebes pranë Shërbimit Social Shtetëror në rastin kur lindja e fëmijës ka ndodhur në shërbimin spitalor jopublik të licensuar sipas legjislacionit në fuqi dhe në rastin kur fëmija është lindur jashtë territorit të Shqipërisë.

Në të dyja rastet prindi/prindërit e fëmijës duhet të paraqesin pranë Shërbimit Social Shtetëror dokumentat e mëposhtme:

- a) Certifikatë e lindjes
- b) Certifikatë familjare
- c) Fotokopje të mjeteve të identifikimit të të dy prindërve;

Në rast së fëmijët kanë lindur në Spital Jo Publik certifikata personale dhe familjare duhet të kenë në fund shënimin “Lindje në institucion jopublik (emri i institucionit), lëshohet për efekt të përfitimit të ndihmës së menjëhershme financiare” (Bonusi).

Në rast së fëmijët kanë lindur jashtë territorit të Shqipërisë certifikata e lindjes dhe familjare duhet të kenë në fund shënimin “Lindje jashtë shtetit, nr... akti, datë..., muaj..., viti, vendin ku ka ndodhur lindja, lëshohet për efekt të përfitimit të ndihmës së menjëhershme financiare, regjistruar brenda afatit 90-ditor (Bonusi).

Tërheqja e çekut bëhet personalisht vetëm nga prindi/prindërit dhe afati është 1 vit kalendarik nga dita e lindjes së foshnjës, për foshnjat e lindura brenda ose jashtë shtetit.